



Mbështetje e mëtejshme Institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Projekt i financuar nga BE,
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

FUSHËBETEJAT E REJA

AKTIVITETI I GRUPEVE EKSTREMISTE NË RRJETET SOCIALE NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE IRJM

Nëntor 2017



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Implementuar nga një konsorcium
i udhëhequr nga B&S Europe



Mbështetje e mëtejshme Institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Projekt i financuar nga BE,
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

FUSHËBETEJAT E REJA

AKTIVITETI I GRUPEVE EKSTREMISTE NË RRJETET SOCIALE NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE IRJM

Nëntor 2017



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Implementuar nga një konsorcium
i udhëhequr nga B&S Europe

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Vesë Kelmendi dhe Shpat Balaj

Redaktimi i brendshëm: Skender Përteshi dhe Florian Qehaja

Rishikimi i jashtëm: Shpend Kursani

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën shqipe.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Te drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht ato të partnerëve a të donatorëve të saj.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
GJETJET KRYESORE	8
PËRDORIMI I RRJETEVE SOCIALE NGA GRUPET EKSTREMISTE	10
TRENDET GJATË PERIUdhËS SË HULUMTIMIT	16
FAQET MË AKTIVE TË GRUPEVE EKSTREMISTE	22
REKOMANDIMET	24
BIBLIOGRAFIA	25

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Kanalet të cilat shpërndajnë materiale propagandistike për pjesëmarrje në Siri dhe Irak (Al-Muwahhidun Shqip dhe Tehuidi. com) Qasur: Më 5 Janar 2017	11
Figura 2: Al Hak Media, kanali i përdorur nga grupet ekstremiste Qasur më 7 Maj 2017	12
Figura 3: Raportimet e drejtpërdrejta nga fushëbetejat përmes profileve dhe faqeve në Facebook. Qasur më 1-5 qershor 2017.	15
Figura 4: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj zgjedhjeve, udhëheqësve shtetërorë dhe atyre fetarë Qasur më 16 shkurt 2017	17
Figura 5: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj imamëve të Bashkësive Islame (Kosovë, Shqipëri dhe IRJM) Qasur më 26 mars 2017	17
Figura 6: Imamët më të ndjekur dhe më të pëlqyer sipas profileve të analizuara në raport Qasur më 30 maj 2017	19
Figura 7: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj sulmeve terroriste Qasur më 30 qershor 2017	20
Figura 8: Përkrahja ndaj udhëheqësve shqiptarë në ISIS Qasur më 8 qershor 2017	21
Figura 9: Faqet më aktive/ndjekura nga profilet e analizuara në raport Qasur qershor 2016 deri më qershor 2017	23

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Platformat online janë shfrytëzuar mjaft shumë për propagandë me qëllim të bindjes së individëve të ndryshëm, sidomos të të rinjve, për t'i mbështetur grupet e ndryshme luftuese në Siri dhe Irak. Një numër i caktuar i individëve që nuk i janë bashkangjitur formacioneve të ndryshme në fushëbeteja janë bërë pjesë e propagandës nëpërmjet rrjeteve sociale, duke i ofruar mbështetje ISIS-it dhe organizatave tjera aktive në Siri nëpërmjet profileve të tyre online. Ndërkaq, një pjesë e vogël e personave, profilet e të cilëve i kemi analizuar, gjenden në konfliktin e Sirisë dhe i përdorin profilet e tyre për të shpërndarë informacione rreth konfliktit dhe për qëllime propagandistike. Ajo çka vërehet si karakteristikë e shumicës së profileve dhe llogarive të analizuar është shoqëria e përbashkët virtuale mes tyre.

Si pjesë e propagandës online të grupeve ekstremiste janë identifikuar lokacionet e faqeve dhe profileve në Kosovë, Shqipëri dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). Shpërndarja e materialeve zyrtare propaganduese të ISIS-it dhe organizatave tjera në gjuhën shqipe ka mund të ketë ndikuar në rritjen e përkrahjes për të ashtuquajturin "Shteti Islamik".

Metodologjia e përdorur gjatë hulumtimit për këtë raport përfshin analizimin e të dhënave dhe informatave të mbledhura nga faqet e mbyllura dhe grupet/rrjetet në të cilat mund të çasesh vetëm me ftesë. Diskutimet në këto grupe të mbyllura janë më të sinkerta dhe të hapura për dallim nga faqet publike për shkak se janë më pak të ekspozuara ndaj mbikëqyrjes nga rrjetet përkatëse. Një përshkrim i saktë i metodologjisë është shmangur, në mënyrë që të parandalohen kundër-masat që potencialisht mund të merren nga administratorët e këtyre grupeve të mbyllura. Siç është bërë e qartë, ky raport pretendohet të jetë pikë-nisja e monitorimit të vazhdueshëm të grupeve ekstreme shqip-folëse në platformat online.

Ky hulumtim është i bazuar kryesisht në tri kategori të faqeve online: (i) ato pro dhunës dhe përkrahjes së grupeve ekstremiste (ii) materiale propagandistike, si thirrjet për xhihad apo mbështetja për hoxxhallarët e burgosur; dhe (iii) trendet dhe qëndrimet e tyre ndaj shtetit, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi. Për të kuptuar rëndësinë e internetit, përkatësisht të faqeve të rrjeteve sociale, të tilla si Facebook, Youtube dhe të tjera ne kemi analizuar edhe disa nga intervistat me personat të cilët ishin pjesë e konfliktit në Siri dhe Irak. Sipas të intervistuarëve, shumica e tyre kanë përdorur platformat "Facebook" dhe "YouTube" për t'u informuar rreth konfliktit në Siri dhe Irak, për dallim nga propaganda e përhapur në shtetet e BE-së

që kryhet përmes platformës "Twitter".¹ Për më tepër, pamjet shqetësuese të civilëve të vrarë dhe ideja e të qenit protagonist në "krijimin e Kalifatit përmes xhihadit" ka shtyer individë të ndryshëm të kenë rol aktiv në rrjete sociale në shërbim të propagandës ekstreme. Narrativa e përdorur nga këta individë vazhdimisht thërret për mbrojtjen e Islamit nga ata që prej tyre quhen "kryqtarë" dhe prioritizimi i atyre që i konsiderojnë armiq si Hebrenjtë, komunitetet "Alewi" dhe predikuesit tradicional të Islamit.

Nga dokumentacionet e Prokurorisë së Kosovës për individët të cilët janë të akuzuar për veprat penale, si pjesëmarrje dhe rekrutim në organizata si ISIS dhe të tjera, është vërejtur që të akuzuarit për pjesëmarrje në luftën e Sirisë dhe Irakut komunikimin kryesisht e kanë zhvilluar nëpërmjet aplikacionit "chat" në Facebook si dhe me numra të ndryshëm të operatorëve të telefonisë mobile në Kosovë – Vala dhe IPKO.² Gjatë komunikimit të tyre ata kanë përdorur nofka të ndryshme për pjesëmarrjen e tyre në Siri.

Zakonisht, personat në fjalë kanë qenë të koordinuar në mes vete për kohën e nisjes dhe pastaj disa prej tyre kanë informuar familjarët e tyre nëpërmjet SMS-ve (mesazheve telefonike) apo nëpërmjet aplikacionit Skype.³

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka krijuar një bazë të të dhënave e cila përfshinë shumicën e faqeve në Facebook, Youtube dhe aplikacione të tjera ku promovohet dhuna si dhe propaganda rreth ISIS-it dhe organizatave tjera terroriste. Madje, në këto faqe bëhet thirrje për t'u bashkangjitur në *xhihad*. Analiza e këtyre kanaleve në gjuhën shqipe ka filluar nga dhjetori i vitit 2016 deri në qershor të vitit 2017. Në këtë drejtim, janë analizuar 60 faqe në Facebook, 4 grupe të mbyllura, më shumë se 120 profile individuale dhe 6 kanale në Youtube.

1 Berger.J & Jonathon.M "The ISIS Twitter Census – Defining and describing the population of ISIS supporters on Twitter" Center for Middle East Policy at BROOKINGS, March 2015. Accessed on June 2017. Available at: https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/isis_twitter_census_berger_morgan.pdf

2 Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës/Departamenti për Krime të Rënda: Aktakuza PPS. Nr. 25 /2015, Prishtinë, 4 dhjetor 2015.

3 Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës/Departamenti për Krime të Rënda: Aktakuza PPS. Nr. 25 /2015, Prishtinë, 4 dhjetor 2015 dhe Aktgjykimi nga Gjykata Themelore Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, Nr. PKR 54/15, 20 maj 2016.

GJETJET KRYESORE

- Platformat më të përdorura nga rekrutuesit dhe ekstremistët e dhunshëm në vendet shqipfolëse janë Facebook dhe Youtube;
- Fjalët më të përdorura nga profilet e analizuara janë: Teuhid, Taghut, Munafik, Kufr, Islamofob, Xhihad, Shehid, Hoxhallarët e Hakut, Luanët, Muxhahedinët, Kryqtarë, Shia, Shteti Islamik, Ushtarët e Allahut, Islami nën sulm, Rexhimi i Asadit, Shami, Jahudi, Eja në Kalifat, Nusët e Xhihadit, Besnik ndaj Allahut, Përkraheni Xhihadin, Luftë Perëndimit, Luanët e Kalifatit dhe Të pa fe;
- Individët e analizuar propagandojnë kundër sistemit sekular të Kosovës dhe Ballkanit duke ju referuar proceseve zgjedhore, dhe jo vetëm, si procese që bien në kundërshtim me besimin Islam për shkak se nuk janë në funksion të të ashtuquajturit "Ligji të Allahut";
- Narrativi i përdorur nga profilet e vë theksin në komunitetin Hebrenjë, Alewi dhe të Krishterë si armiq kryesor të tyre. Ata përdorin edhe fotografi të ndryshme për të "dëshmuar" atë që ata e konsiderojnë si "ndikimi Perëndimor" në shoqëritë Shqiptare;
- Disa nga profilet e analizuara janë pjesë e ISIS-it dhe raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fushëbetejat. Gjithashtu, gjatë kësaj analize është parë që edhe disa prej atyre që janë kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut, vazhdojnë të shpërndajnë materialet e këtyre faqeve dhe profileve;
- Profilet individuale të ekstremistëve të dhunshëm mbështetjen më të madhe e kanë për imamët e dënuar për vepra terroriste lidhur me rekrutimin e pjesëmarrësve në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM. Në anën tjetër, këta mbështetës të imamëve të dënuar nuk pajtohen dhe propagandojnë kundër imamëve që zyrtarisht janë pjesë e Bashkësive Islame të Kosovës, Shqipërisë dhe IRJM-së;
- Ka materiale që ngritin lartë ekstremistët të cilët janë të burgosur duke aluduar në faktin se është nder dhe shërbim ndaj Allahut vuajtja e denimit për të. Kjo ide shpërndahet vazhdimisht në rrjetet sociale për të marrë vëmendjen e individëve tjerë që ndajnë të njejtën ideologji;
- Synimi i propagandës online është depërtimi tek individë, grupe dhe vende të ndryshme në pamundësi për të komunikuar drejtpërdrejtë me to. Shumica e tyre përkrahen hapur grupet ekstremiste por megjithatë në nuk kemi arritur të sigurojmë të dhëna nëse këta persona dëshirojnë të bashkangjiten në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Disa nga profilet individuale tentojnë të fitojnë përkrahës në bazë të komunikimit online;
- Për shkak të politikave të platformave si Facebook, faqet me përmbajtje ekstreme mbyllen, por megjithatë shumica e këtyre faqeve ri-hapen përsëri me emra të njëjtë ose me karakteristika të njëjta si faqja paraardhëse.

PËRMBLEDHJA

Platformat më të përdorura



FACEBOOK



TELEGRAM



YOUTUBE

Numri i faqeve të analizuara **60+**

Lloji i faqeve



FAQE PUBLIKE
(FACEBOOK)



GRUPE TË MBYLLURA
(FACEBOOK)



KANALE PUBLIKE
(YOUTUBE)



CHAT PUBLIK
(TELEGRAM)

Fjalët më të përdorura

TAUHID | TAGHUT | QAFIR | MUNAFIK | KUFËR |
ISLAMOFOB | XHIHAD | SHEHID |
HOXHALLARËT E HAKUT | LUANËT | MUXHAHID |
KRYQTARË

Përdorues të platformës Facebook⁴



KOSOVË
860.000

SHQIPËRI
1.400.000

MAQEDONI
1.000.000

Numri i profileve individuale **150+**

Lloji i materialit të shpërndarë

THIRRJE DHE PËRKRAHJE DIREKTE PËR XHIHAD

PËRKRAHJE PËR XHIHADISTËT NË SIRI

FJALIME TË UREJTJES

MATERIALE KUNDËR IDEOLOGJIVE
TË SHTETEVE TË NDRYSHME

PËRKRAHJE PËR SULMET TERRORISTE

INFORMACIONE NGA AGJENSIA E LAJMEVE AMAQ TË
PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE

Vendet ku veprojnë

KOSOVË SHQIPËRI MAQEDONI

⁴ Internet World Stats "Usage and Population Statistics"
<http://www.internetworldstats.com/europa2.htm#kv> Qasur më 25 maj 2017

PËRDORIMI I RRJETEVE SOCIALE NGA GRUPET EKSTREMISTE

Për dallim prej propagandës nga kanalet zyrtare të grupeve ekstremiste në botë si ato të ISIS-it, karakteristikë e profileve/faqeve aktive në gjuhën shqipe është mungesa e profesionalizmit në krijimin dhe editimin e materialeve propaganduese. Ndonëse materialet e shpërndara janë vizualisht të dobëta, megjithatë ato në shumicën e rasteve përmbajnë mesazhe, citime dhe trende të njëjta me propagandën zyrtare. Në disa profile/faqe shpërndahen materiale me titra të përkthyer në gjuhën shqipe të mediave zyrtare të grupeve ekstremiste, gjë që nënkupton përfshirjen e drejtpërdrejtë të profileve/faqeve shqip me kanalet zyrtare të tyre⁵. Përveç që kanë numër të konsiderueshëm të pëlqimeve dhe ndjekësve, këto faqe në masë të madhe janë pasardhëse të faqeve që janë mbyllur më parë. Një ndër faqet kryesore ishte "Hilafeti",⁶ mirëpo kjo faqe tashmë është mbyllur dhe sipas analizës tonë rreth aktivitetit të tyre, shumica e ndjekësve janë transferuar në faqe të tjera të cilat do të zërthehen më poshtë në këtë raport. Raporti nuk mund të bëjë vlerësimin ekzakt të numrit të personave të përfshirë në grupe të ndryshme në rrjetet sociale, pasi që shumica e profileve janë pjesë e të gjitha grupeve të identifikuara dhe rrjeteve tjera sociale aktive. Si rezultat i kësaj, nuk mund të dalim me numër të saktë të individëve që ndjekin grupet e identifikuara gjatë raportit. Rrjedhimisht është e vështirë të kemi vlerësim të numrit të anëtarëve kosovarë ose grupimin e anëtarëve në bazë të shtetësisë.

Në të vërtetë, ky është një tregues që aktiviteti i tyre është më i lartë dhe më i vjetër sesa statistikisht aktuale që gjenden në këtë raport. Lloji i postimeve në profilet/faqet e analizuara kryesisht është i njëjtë: doktrina të orientuara në legjitimitetin e "luftës së shenjtë",⁷ thirrje kundër shteteve perëndimore, kundër komuniteteve Shia dhe të Krishterë dhe të tjetëve që nuk përkrahin bindjet e tyre apo të organizatave terroriste. Mirëpo, vlen të theksohet se në këto grupe është bërë thirrje edhe për sulme ndaj vendeve si Arabia Saudite dhe Turqia, për arsye se këto shtete me shumicë Muslimane i shohin si bashkëpunëtore të perëndimit dhe tradhtarë të Islamit. Vizita e presidentit amerikan Donald Trump në Arabinë Saudite dhe lidhja e marrëveshjeve për shitblerje të armëve është diskutuar dhe kritikuar shumë nga aktivistët dhe simpatizuesit e ISIS-it në rrjete sociale.⁸ Krahas kësaj, janë shpërndarë pamje të rënda nga vendet e prekura nga lufta, përkrahje për *xhihadistët* shqiptarë e të huaj⁹ dhe raportimet të drejtpërdrejta nga konfliktet ku është i përfshirë ISIS-i.¹⁰

Një pjesë e madhe e materialeve të shpërndara në profilet/faqet e radikalizuara janë mësimet fetare të orientuara në proklamimin e "thirrjes në xhihad". Në parim, shpërndarja e këtyre materialeve nuk lidhet domosdoshmërisht me ekstremizmin e dhunshëm,

5 Shih p.sh. në Youtube : Al-Hak Media <https://www.youtube.com/watch?v=e8wxJLU3r-U>

6 Faqja Hilafeti <https://www.facebook.com/hilafeti/>

7 Faqja "Bota Islame" <https://www.facebook.com/damirtirana/>

8 Faqja "Bota Islame" <https://www.facebook.com/damirtirana/>

9 Faqja "Eja në Islam" <https://www.facebook.com/EJA-NE-ISLAM-603805896481591/>

10 Faqja "Agimi i Vërtetë" <https://www.facebook.com/Agimi-i-V%C3%ABrtet%C3%AB--342087872860883/>

por duke e pasur parasysh aktivitetin e përgjithshëm të profileve/faqeve të analizuara, përdorimi i tyre në këto faqe ka karakter negativ për shkak të gjuhës së urrejtjes dhe promovimit të përgjithshëm të propagandës së tyre që në mënyrë indirekte është një motiv për pjesëmarrje në konfliktet e huaja në Siri dhe Irak.¹¹ Qëllimi i përdorimit të këtyre materialeve fetare është arsyetimi i dhunës përmes “mjeteve legjitime” që ata propagandojnë si dhe balancimi dhe fshehja pas faqeve fetare me karakter edukativ.¹² Këto kanale në Youtube dhe Facebook shërbejnë për ligjërime të ndryshme për konfliktin në Siri dhe Irak. Një ndër kanalet më të rëndësishmet në promovimin e *xihadistëve* është “*Al-Muwahhidun Shqip*”, i cili është mbyllur.

Ndërsa, janë edhe kanalet si “*Shpata e Mëshiruesit*”¹³, video të tjera në kanalën Youtube ku flasin për “*Shehidat e Ballkanit*”¹⁴ apo “*Ke durim o shpirti im*”¹⁵ dhe shumë materiale të tjera propaganduese.

Faqja e internetit “*Thirja në Tehid*” ka shërbyer për të lëshuar materiale të ndryshme për “luftën e shenjtë” dhe mohimin e demokracisë. Kjo faqe është mbyllur, por ne kemi siguruar pamje të publikuara në këtë webfaqe para se të mbyllet (shih Figurën 1).

Postimet e tilla pëlqehen dhe shpërndahen më shumë nga audienca dhe në këtë mënyrë bëhet edhe më i lehtë targetimi i luftëtarëve potencial sipas pëlqimeve, komenteve apo shpërndarjeve që arrijnë të marrin ato postime.




Figura 1: Kanalet të cilat shpërndajnë materiale propagandistike për pjesëmarrje në Siri dhe Irak (Al-Muwahhidun Shqip dhe Tehuidi. com) Qasur: Më 5 Janar 2017

11 Faqja “Minberi i Teuhidit” <https://www.facebook.com/minbermedia/>

12 Shih Fotografitë në figurën 1

13 Shih në Youtube: “Shpata e Mëshiruesit” <https://www.youtube.com/channel/UCOJWUIs7vtq7uzkzqNsjtFw>

14 Shih në Youtube: “Shehidat e Ballkanit” <https://www.youtube.com/watch?v=GfE6fGxY65E>

15 Shih në Youtube: “Ke durim o shpirti im” <https://www.youtube.com/watch?v=qamyNkxbOMM&t=97s>

Ndërkohë, ndër kanalet më të sofistikuara të grupeve ekstremiste është “Al Hak Media”¹⁶ e cila shpërndan video të ndryshme përmes të cilave promovohet lufta, pamjet e luftimeve në Siri dhe Irak, pamje të xhihadistave duke i kryer obligimet fetare si dhe video propaganduese kundër atyre që përkrahësit e këtij kanali i konsiderojnë armiq. Al Hak Media është faqe relativisht e re e cila është hapur në fund të vitit 2016, e cila ka gjithsej 105 ndjekës me rreth 18 mijë shikime në videot e tyre (shih Figurën 2).

Gjatë punës hulumtuese kemi hasur në profile të caktuara të individëve që potencialisht ndodhen në konfliktet në Siri dhe Irak. Këto profile karakterizohen me numër të vogël të miqve, emra të rrejshëm dhe me profile private, me pak ose asnjë postim, gjegjësisht informacion të dhënë për bartësin e profilit.

Këto profile aktivizohen herë pas here në disa nga grupet e analizuar dhe japin mesazhe apo informacione të ndryshme për vdekjen e xhihadistëve dhe informacione të tjera nga konflikti. Kjo formë e komunikimit është konfirmuar edhe nga luftëtarët e huaj të rikthyer të cilët QKSS-ja i ka intervistuar dhe kanë zbuluar të kenë zhvilluar kontakte me disa shqiptarë në ISIS që u kanë ndihmuar më pas t’i bashkëngjiten konfliktit në Siri dhe Irak. Ishte rasti i B.B i cili konstatoi se “një ndër arsyt kryesore që iu bashkëngjita konfliktit ishin pamjet dhe vrasjet e civilëve në Siri që i shikoja në Youtube. Përmes Facebook-ut komunikova me një shqiptar atje i cili më tregoi se kënd ta kontaktoj në Kosovë. Më pastaj morra biletën dhe udhëtova drejt Sirisë dhe Irakut”.¹⁷




Figura 2: Al Hak Media, kanali i përdorur nga grupet ekstremiste Qasur më 7 Maj 2017

¹⁶ Shih në Youtube “Al Hak Media” <https://www.youtube.com/channel/UCKmEVbNeJD7BpXvHffnZ3gA>

¹⁷ Intervistë me ish-luftëtarin e ri-kthyer B.B 05/09/2016

Gjatë analizimit të transkripteve nga Prokuroria e Kosovës për rastet e individëve që kanë marrë pjesë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, gjithashtu është vërejtur që ish-luftëtarët e huaj kanë komunikuar edhe me numrat e telefonit të operatorëve vendorë të telefonisë mobile, përkatësisht Vala dhe IPKO, të cilët i kanë shfrytëzuar për të kërkuar nga familjarët e tyre që t’ju mbushen llogaritë e telefonave të tyre nga Kosova. Madje, disa prej tyre i kanë mbajtur të informuar në baza të rregullta familjarët e tyre për gjendjen e tyre ose të miqve të tyre në rast se nëse janë plagosur apo ka vdekur ndonjëri prej tyre në konflikt.¹⁸ Një nga të intervistuarit kishte deklaruar se ishte detyruar të dal në fotografi i armatosur dhe me uniformë me qëllim që liderët brenda kampit të postojnë këtë fotografi në Facebook për të nxitur të rinjtë nga Kosova për t’u bashkangjitur në konflikt. Ai kishte rrëfyer: *“po, dola ne fotografi, por u detyrova sepse përndryshe do më refuzohej kërkesa për t’u kthyer në Kosovë. Ajo fotografi kishte për qëllim joshjen e të rinjve për t’u bashkangjitur në konfliktin e Sirisë dhe Irakut”*.¹⁹

Propaganda online e grupeve ekstremiste ka bërë që kjo mënyrë komunikimi të bëhet burimi kryesor i informacionit për ngjarjet të cilat ndodhin në zonat e kontrolluara nga ISIS-i. Ata gjatë tërë kohës akuzojnë mediat ndërkombëtare për “fake news” (lajme të rrejshme) dhe kjo krijon një konfuzion tek personat të cilët ndjekin trendin e grupeve ekstremiste. Fushata mediatike e organizatave terroriste, si ISIS dhe organizatave të tjera, ka krijuar hapësirë që individët potencialisht të radikalizuar nuk kanë pranuar të marrin informacione që shpërfaqin narrativët kundër ISIS-it dhe grupeve të tjera të cilat ata i konsiderojnë si të drejta në qëllim, kauzë dhe veprim.

Këto grupe dhe këta individë kanë krijuar komunitetin e tyre brenda rrjeteve sociale që në të vërtetë duket të jetë mjaft i izoluar. Për më tepër, brenda këtij komuniteti vërehen/përdoren nofka të ndryshme të cilat përbëhen nga parafjalët si Ebu, Ibn, AL, EL, Isa të cilat vendosen para mbiemrave ose vendeve të prejardhjes së tyre, si për shembull “Ebu Al-Kosovi”, “Ibn Isa Islami”, “Ibn Al Arnaut” dhe të tjera. Përmes këtij komuniteti të krijuar ata njohin njëri-tjetrin në bazë të aktiviteteve që i shfaqin në postimet e tyre në rrjetet sociale si dhe raportojnë për situatën e krijuar në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Përveç kësaj, në faqet dhe profilet e analizuara, ata përdorin edhe narracione për rregullat të cilat gratë duhet të ju binden brenda të të ashtuquajturit “Shteti Islamik”. Disa prej tyre hapin edhe profile që i vendosin emra të grave apo fotografi të ndryshme propagandistike të cilat paraqesin gratë e izoluar nga rrethi i tyre.


Hulumtuesit e QKSS-së kanë vërejtur zhvendosjen e komunikimit në “chat”-e publike dhe të mbyllura në platformat, si Telegram dhe Signal. Siç vërehet nga fotografitë e mëposhtme (shih Figurën 3), mund të shihen disa nga narracionet me të cilat shërbehen individët për të raportuar në lidhje me luftimet në Siri dhe Irak si dhe disa propaganda të rrejshme të cilat ata i përdorin.²⁰ Ne kemi siguruar qasje edhe në 4 grupe të mbyllura në të cilat postohen zakonisht lajme që burojnë nga agjencia e lajmeve Amaq, por këto lajme postohen apo përkthehen në gjuhën shqipe. Llojet e postimeve janë kryesisht fotografi, lokacione apo info-grafika dhe video të ndryshme përmes të cilave dëshirojnë që t’i mbajnë të informuar ndjekësit e tyre me materiale të ndryshme rreth zhvillimeve në luftën e Sirisë.²¹

18 Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës/Departamenti për Krime të Rënda: Aktakuza PPS. Nr. 25 /2015, Prishtinë, 4 dhjetor 2015.

19 Intervistë me ish-luftëtarin e ri-kthyer C.D 06/07/2016

20 Faqja “Lugina Al-Afyah: <https://www.facebook.com/LuginaAlAfyah/>

21 Të dhëna të grumbulluara nga baza e të dhënave për rrjetet sociale/ QKSS (2016-2017)






Figura 3: Raportimet e drejtpërdrejta nga fushëbetejat përmes profileve dhe faqeve në Facebook. Qasur më 1-5 qershor 2017.

TRENDET GJATË PERIUDHËS SË HULUMTIMIT

Një dukuri interesante gjatë muajve të fundit ishte edhe thirrja e individëve me bindje ekstremiste në rrjete sociale për të bojkotuar zgjedhjet në Kosovë dhe Shqipëri. Për më tepër, diskursi i tyre është edhe kundër subjekteve politike të cilat konsiderohen se kanë bazë fetare, për shkak se, sipas tyre, pjesëmarrja në proceset demokratike është në kundërshtim me parimet e tyre (shih Figurën 4). Profilët e identifikuar brenda këtij raporti promovojnë idenë se muslimanët e dedikuar nuk duhet të kenë rol në zgjedhjen e Kryeministrit, apo të Kryetarëve Komunal apo Presidentit sepse në atë mënyrë i kontribuojnë sistemit sekular dhe jo Islamit.

Sipas tyre, Muslimanët nuk duhet të qeverisen nga të pa-fetë. Për më tepër, prej tyre promovohet edhe ideja e mos-kryerjes së obligimeve financiare ndaj një shtetit sekular; mos-edukimi i fëmijëve në shkolla publike të udhëhequra nga institucionet shtetërore; ndalimi i punësimit në institucione të shtetit sekular si: Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, administratën publike dhe institucionet të tjera që janë pjesë e sistemit.






Figura 4: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj zgjedhjeve, udhëheqësve shtetërorë dhe atyre fetarë Qasur më 16 shkurt 2017

Ndërkaq, sipas analizës tonë në këtë raport të gjitha këto faqe dhe profile individuale njohin njëri tjetrin dhe përkrahin idenë se vetëm imamët të cilët janë në burgje janë “hoxhallarë të haku”²² (shih Figurën 5).



Figura 5: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj imamëve të Bashkësive Islame (Kosovë, Shqipëri dhe IRJM) Qasur më 26 mars 2017

22 Shih në Youtube “Burgu është për burra” https://www.youtube.com/watch?v=9d4N_gAm4Os

Profilet individuale të analizuara brenda këtij raporti që postojnë më së shumti janë për imamët nga Kosova, IRJM dhe Shqipëria të cilët janë të dënuar për vepra terroriste si rekrutimi; si dhe për veprën tjetër nxitjen e gjuhën e urrejtjes. Prandaj, shpeshherë shpërndahen materiale ku krahasohen imamët të cilët ata i konsiderojnë mashtrues me imamët të cilët janë në burgje. Sa për ilustrim, ata kanë postuar një video duke propaganduar kundër një imami të Kosovës, përkatësisht imamin Enis Rama nga Mitrovica, të cilin e krahasojnë me një imam tjetër, siç është ai nga Shkupi, Rexhep Memishi, i cili akuzohet për vepra terroriste.²³ Këtë krahasim e bëjnë duke i dhënë epitete imami nga Shkupi si i “devotshëm”, ndërkaq kanë bërë thirrje që imami nga Mitrovica mos të ndiqet ose pëlqehet nëpër mediat sociale. Në këtë ligjëratë, imami Enis Rama tregon rreth procesit të zgjedhjeve/votimeve ku, sipas tij, në parim asnjë mysliman nuk duhet të mendojë kundër këtyre proceseve apo të largohet nga pjesëmarrja në zgjedhje. Për më tepër, sipas imami Rama, duhet të ketë pjesëmarrje efektive në proceset që sjellin dobi dhe se nuk duhet të lejohet që të keqpërdoret vota. Nga ana tjetër, qëndrimet e imami nga Shkupi janë krejtësisht të kundërta duke theksuar se dalja apo votimi në zgjedhje është mohim i fesë Islame.

Gjatë ligjërimit të tij, ai u drejtohet të gjithë hoxhallarëve në këtë mënyrë: *“disa hoxhallarë bëjnë propagandë se duhet të dalin në zgjedhje dhe dëshirojnë edhe vllaznitë të tjerë t’i shtynë në këto zgjedhje të taghutit. Këto zgjedhje nuk emërohen ndryshe në terminologjinë e Sheriatit, përveç zgjedhje të taghutit dhe kufrit sepse demokracia është fe dhe është kufër dhe taghut, dhe kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, atij nuk i pranohet. Në akidën e demokracisë thuhet që ‘shumica sundon pakicën’. Andaj, zgjedhjet janë për të bërë ligjvënie dhe ligjvënia është taghut.”*

Qëndrime të tilla kanë pothuajse ndaj të gjithë imamëve të cilët janë pjesë e Bashkësisë Islame në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM (dhe jo vetëm ndaj tyre) të cilët punojnë dhe i përkrahin institucionet e shtetit.

Në figurën e mëposhtme gjenden faqet e imamëve në Facebook që janë burgosur për vepra terroriste në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM, përderisa ligjëratat e tyre shpërndahen më së shumti në profilet e analizuara në raport. Më saktësisht, në vijim janë të paraqitura numri i pëlqimeve dhe i ndjekësve të këtyre faqeve në Facebook. Megjithatë, ne nuk mund të vërtetojmë se kush qëndron prapa këtyre faqeve pas arrestimit të imamëve.

23 Shih në Youtube “Zbulimi i mashtrimeve të Enis Rames-rreth Votimeve” <https://www.youtube.com/watch?v=jPC4jAVPI80>




Figura 6: Imamët më të ndjekur dhe më të pëlqyer sipas profileve të analizuara në raport Qasur më 30 maj 2017

Individët të cilët mirëmbajnë këto faqe kanë aktivitet të vazhdueshme në promovimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të *xihadistëve*. Aktiviteti i faqeve të këtilla shtohet kur ndodhin sulme terroriste në botë me postime të ndryshme në përkrahje të atyre sulmeve. Kjo është vërejtur edhe gjatë sulmeve në muajin maj dhe qershor të vitit 2017 në Angli, gjegjësisht

sulmet në koncertin e Manchester dhe në sulmin tjetër tek “London Bridge”, ku shumica e profileve dhe disa faqeve në Facebook i ofronin mbështetje sulmuesve (shih Figurën 7). Sipas tyre, aktet e tilla duhet të përkrahën për faktin që po vriten Muslimanë të pafajshëm në Siri dhe Irak, ndërsa faji për të gjitha këto vrasje i vihet vendeve të perëndimit, Arabisë Saudite dhe Turqisë.

Gjatë analizimit të profileve dhe grupeve në rrjetet sociale është vërejtur shpërndarja e materialeve të cilat nxisin urrejtje ndaj fesë katolike, hebrenjëve dhe sektit Shia. Argumentet të cilat ata përdorin për të arsyetuar urrejtjen janë të ndryshme nga njëra tjetra. Problemi që e konsiderojnë me sektin Shia ka prapavijë fetare, dhe sipas profileve dhe grupeve ekstremiste të analizuara Shiat janë sekt të refuzuar nga besimi Islam. Qasja e tyre ndaj Krishterizmit dhe Hebrenjëve në një mënyrë ka karakter hakmarrës për arsye se këto dy besime konsiderohen si shkaktare të problemeve të muslimanëve në botë. Grupet ekstremiste konsiderojnë që këto dy besime janë të privileguara më shumë nga vendet e Perëndimit dhe sipas tyre këto vende kanë synim përhapjen e krishtërizmit në gjithë botën, përfshirë vendet e Lindjes së Mesme. Në rastin e Kosovës, Shqipërisë dhe IRJM-së janë ngritur debate mbi diskriminimin e Muslimanëve në këto

vende si psh. ulja e zërit të ezanit, moslejimi i bartjes së shamive në shkolla publike, demolimi i xhamive, mungesa e xhamive etj. Grupet ekstremiste kanë shfrytëzuar këto debate për t'i shtyrë përpara agjendat e tyre ekstreme që kanë për qëllim rekrutimin dhe nxitjen e urrejtjes ndaj besimeve tjera. Qëllimi i përdorimit të çështjeve të lartpërmendura nga grupet ekstremiste ishte proklamimi i "jetës së barabartë" në të ashtuquajturin "Shteti Islamik", të cilën nuk mund ta gjejnë në vendet e tyre. Narrativa e përdurur si anti-hebrejë dhe anti-shia çojnë në ndërtimin e armiqve të rinj për Shqiptarët, sepse një tregim i tillë nuk ka qenë kurrë i pranishëm më parë, nuk ka gjurmë të gjetjes së njëjtë gjatë Perandorisë Osmane. Vlerësimi ynë tregon se kudo që ekziston një tregim i tillë kundër komuniteteve hebrenjë dhe shia, ka potencial për ekstremizëm të dhunshëm.



Figura 7: Qëndrimet e mbështetësve të grupeve ekstremiste ndaj sulmeve terroriste Qasur më 30 qershor 2017

Siç është analizuar në këtë raport, trendi i fundit në këtë aspekt ishte përhapja e lajmit për vdekjen e Lavdrim Muhaxherit, i cili u raportua të jetë vrarë. Rrjedhimisht, ai gëzoi përkrahje të madhe nga grupet të cilat janë të radhitura në këtë hulumtim. Gjithashtu,

vdekja e tij është përkrahur edhe nga 3 profile të personave që janë kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut, të cilët tashmë gjenden në procedura gjyqësore (shih Figurën 8).




Figura 8: Përkrahja ndaj udhëheqësve shqiptarë në ISIS Qasur më 8 qershor 2017

FAQET MË AKTIVE TË GRUPEVE EKSTREMISTE

Në figurat e paraqitura në vijim janë të radhitura faqet më të ndjekura që shërbejnë si aparat propagandistik për idetë ekstremiste. Këto faqe përkrahin hapur "Shtetin Islamik" dhe bëjnë thirrje për t'u bashkangjitur në luftën të cilën ata e konsiderojnë të shenjtë. Qëndrimet dhe ndjekësit e të gjitha këtyre faqeve janë kryesisht të njëjta me njëra tjetrën. Nëse e krahasojmë numrin total të përdoruesve të platformës Facebook në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM, atëherë vërejmë se faqet e tilla përcillen nga një përqindje shumë e vogël e përdoruesve të Facebook-ut.

Këto faqe përmbajnë:

- Përkthimin e teksteve të agjencisë zyrtare mediale të ISIS-it, Amaq;
- Thirrje për xhihad;
- Përkrahje për hoxhallarët e arrestuar;
- Pamje të masakrave në Siri;
- Mbështetje për sulmet terroriste ndaj Perëndimit;
- Nxitje e urrejtës ndaj vendeve të Perëndimit, Turqisë dhe Arabisë Saudite;
- Kundër imamëve të Bashkësive Islame në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM;
- Raporte të rregullta nga Der'a Mosul, Raqqa dhe Afghanistan;
- Emrat e të vrarëve në konflikt;
- Video të xhihadistëve në shërbime dhe aktivitete të ndryshme;
- Kundërshtime ndaj kurdëve, amerikanëve dhe vendeve arabe;
- Tekste të përkthyer nga personat e huaj të radikalizuar;
- Urrejtje ndaj besimeve tjera.




Figura 9: Faqet më aktive/ndjekura nga profilet e analizuarë në raport Qasur qershor 2016 deri më qershor 2017

REKOMANDIMET

- Dijetarët fetarë nëpërmjet institucioneve fetare (në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM) duhet të jenë më aktiv në rrjetet sociale duke u përqendruar tek gupet që menaxhohen nga qarqet ekstremiste në mënyrë që të ofrojnë argumente fetare në luftimin e propagandës online;
- Bashkësitë Islame në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM nuk kanë platformë serioze online të cilat në njërin anë do të kontribuonin në edukimin fetar për të rinjtë dhe në anën tjetër do të ndikonin në luftimin ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet komunikimit. Bashkësitë Islame duhet të ndërtojnë platforma serioze online në kanalet e rrjeteve sociale (Youtube, Facebook, Twitter) në mënyrë që strategjikisht të luftojnë argumentet të cilat i përdorin grupet ekstremiste për qëllime të rekrutimit;
- Krijimi i një rrjeti rajonal për monitorim të vazhdueshëm të grupeve ekstremiste në rrjetet sociale dhe identifikimi i profileve/grupeve ekstremiste të cilat propagandojnë për konfliktin e Sirisë dhe Irakut dhe çështje tjera që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Rrjeti rajonal të jetë në bashkëpunim me bashkësitë fetare dhe institucionet e sigurisë në vendet përkatëse (Kosovë, Shqipëri dhe IRJM) në prodhimin e kundër-narrativave ndaj diskursit të profileve/grupeve ekstremiste.
- Metodologjia e këtij punimi të përdoret si shembull për monitorimin e vazhdueshëm të trendeve të grupeve ekstremiste në rrjete sociale sidomos për institucionet e sigurisë;
- Duhet të organizohen trajnime nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile për të rinjtë në komuna të Kosovës rreth përdorimit të rrjeteve sociale. Kjo do të duhej të bëhej në mënyrë që të verifikohen informacionet e sakta dhe të bëhet identifikimi i propagandës brenda komunitetit të tyre;
- Trajtimi i narrativës kundër komuniteteve të ndryshme si Shia dhe komuniteti Hebrej duhet të konsiderohet si prioritet i institucioneve të sigurisë për shkak të potencialit për dhunë ndaj këtyre komuniteteve;
- Ish-ekstremistët e dhunshëm duhet të shpjegojnë se nuk është heroike shkuarja në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Fushatat e tilla janë të suksesshme të ilustruara përmes videove të shkurta, duke u fokusuar në audiencën e cila mund të ndikohet nga propaganda online;
- Institucionet e vendit duhet të jenë më të përqendruara në rrjetet sociale dhe të krijojnë platforma ku qytetarët mund të raportojnë problemet apo profilet të cilat kanë ndërlidhje me ekstremistët e dhunshëm apo që bëjnë propagandë brenda komunitetit të tyre;
- Bindja e personave të radikalizuar është “ne” kundër “atyre”. Mirëpo, qasja e Qeverisë dhe prijësve fetarë në Kosovë duhet të përqendrohet në kundërshtimin e idesë së tyre. Ata duhet të gjejnë porositë e duhura që këta persona të sfidohen në bindjet e tyre rreth demokracisë, ligjeve dhe institucioneve të shtetit;
- Është thelbësore të krijohen nisma qytetare të cilat mund të ndihmojnë në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë dhe familjarëve të personave që janë pjesëmarrës në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Liderët e komunitetit janë shembuj të akterëve të tjerë të cilët gjithashtu mund të ndërmarrin kundër-narrativë për të adresuar problemet që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm;

BIBLIOGRAFIA

1. Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës/Departamenti për Krime të Rënda: Aktakuza PPS. nr 25 /2015, Prishtinë, 04 Dhjetor 2015
2. Aktgjykimi nga Gjykata Themelore Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda nr PKR 54/15, 20 Maj 2016
3. Intervistë B.B 05/09/2016
4. Intervistë C.D 06/07/2016
5. Berger.J & Jonathon.M "The ISIS Twitter Census – Defining and describing the population of ISIS supporters on Twitter" Center for Middle East Policy at BROOKINGS, March 2015.
Gjindet në: https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/isis_twitter_census_berger_morgan.pdf

Youtube:

6. Al-Hak Media <https://www.youtube.com/ëatch?v=e8ëxJLU3r-U>
7. Shehidat e Ballkanit <https://www.youtube.com/ëatch?v=GfE6fGxY65>
8. Ke durim o shpirti im-llahi Shqip <https://www.youtube.com/ëatch?v=qamyNkxOMM&t=93s>
9. Zbulimi i mashtrimeve të Enis Rames-rreth Votimeve <https://www.youtube.com/watch?v=jPC4jAVPI80>
10. Shpata e Mëshiruesit: <https://www.youtube.com/channel/UCOJWUls7vtq7uzkzqNsjtFw>

Facebook:

11. Faqja Hilafeti <https://www.facebook.com/hilafeti/>
12. Faqja "Bota Islame" <https://www.facebook.com/damirtirana/>
13. Faqja "Ummeti i Teuidit" <https://www.facebook.com/UmmetiiTeuhidit/>
14. Faqja "Eja në Islam" <https://www.facebook.com/EJA-NE-ISLAM-603805896481591/>
15. Faqja "Agimi i Vërtetë" <https://www.facebook.com/AgimiV%C3%ABrtet%C3%AB3420878728608/>
16. Faqja "Minberi I Teuhidit" <https://www.facebook.com/minbermedia/>
17. Faqja "Rexhep Memishi" <https://www.facebook.com/RexhepMemishi01/>
18. Faqja "Gjithnjë me Hoxhallarët" <https://www.facebook.com/Gjithnj%C3%AB-me-Hoxhallar%C3%ABt-235246293293449/>
19. Faqja "Hoxhë Abdurahim Balla" https://www.facebook.com/HoxheAbdurahimBalla/?ref=br_rs
20. Hoxhë "Zequirja Qazimi" <https://www.facebook.com/Hoxh%C3%AB-Zekerija-Qazimi-220931798113728/>
21. Faqja "Islami është Hak" <https://www.facebook.com/Islami-%C3%ABsht%C3%AB-Hak-1651904388408917/>
22. Faqja "Minarja e Bardhë" <https://www.facebook.com/minarja.eBardhe/>

Profilet individuale të koduara:

23. Rreth 150 profile individuale të cilave i mbahet identiteti i tyre
24. Fotografi nga profilet individuale të koduara brenda raportit
25. Grupet e mbyllura në Facebook

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(497-15)

343.3/.7(497-15)

Kelmendi, Vesë

Fushëbetejat e reja : aktiviteti i grupeve ekstremiste
në rrjetet sociale në Kosovë, Shqipëri dhe IRJM / Vesë Kelmendi dhe Shpat Balaj. –
Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2017. – 28 f. : ilustr. ;
21 cm.

1.Balaj, Shpat

ISBN 978-9951-679-69-5

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-69-5



9 789951 679695